

KRCT/QKRMT

14/01/2012

## **MONITORIMI I PROTESTËS SË VETËVENDOSJES NË PIKAT KUFITARE MERDARE DHE DHEU I BARDHË, 14 JANAR 2012**

Ekipet monitoruese të QKRMT-së kanë monitoruara protestën e Lëvizjes VETËVENDOSJE të mbajtur më 14 Janar 2012 afër pikave kufitare në Merdare dhe Dheu i Bardhë, me qëllim të zbatimit të masave të reciprocitetit. Dy ekipet e QKRMT-së kanë qëndruar afër këtyre pikave kufitare që nga fillimi e deri në përfundim të protestës, e më pas edhe i kanë vizituar aktivistët e arrestuar në mesin e të cilëve kishte edhe deputetë të Vetëvendosjes në Kuvendin e Kosovës.

QKRMT gjatë vëzhgimit të saj në dy pikat kufitare vlerëson që intervenimi i policisë për shpërndarjen e protestuesve me qëllim që të ketë liri të plotë të lëvizjes, është bërë pa provokimin e masës, ku u arrestuan mbi 100 protestues në të dyja pikat kufitare. Gjatë kësaj protesta pati dhjetëra të lënduar.

Intervenimi i Policisë së Kosovës ka qenë i pa provokuar nga masa e protestuesve, protestuesit kanë qenë të qetë dhe organizatorët vazhdimisht kanë apeluar për protestë paqësore, duke u mundur që të mbajnë rend dhe qetësi në mesin e protestuesve.

Shpërndarja e protestës në pikën kufitare në Merdare ka filluar në orët e para të protestës, ku pas ndërhyrjes së policisë edhe protestuesit kanë filluar të kundërpërgjigjet me hedhjen e gjëseneve të ndryshme në drejtim të policisë ku edhe ka filluar përshkallëzimi i situatës ku pati edhe policë të lënduar. Gjatë intervenimit të policisë për shpërndarjen e protestuesve në Merdare u përdor gaz lotsjellës, topa uji, spreji si dhe shkopinj gome.

Ndërsa në pikën kufitare tek Dheu i Bardhë rrjedha e protestës nga fillimi i saj e deri në ora 17:45 ka qenë normale dhe pa ndonjë reagim reciprok. Mirëpo në orët e mbrëmjes pas kërkesave të disa hershme të policisë për përfundimin e protestës, protestuesit të gjithë janë ulur dhe kanë qëndruar në mënyrë paqësore, por policia kanë ndërhyrë në shpërndarjen e masës duke filluar edhe arrestimin e tyre. Gjatë arrestimit nuk u kursyen as deputetet e Kuvendit të Kosovës, ku në mesin e tyre ishte edhe Glauk Konjufca i cili mori lëndime gjatë arrestimit në pjesët frontale të fytyrës si dhe u shqelmua në bark. Pas arrestimit të protestuesve, ekipi monitorues i QKRMT-së vizitoi deputet dhe të arrestuarit e tjerë të dërguar në Stacionin Policor në Gjilan, të cilët më pas u liruan për në shtëpi. Pas intervistave me ta, ata deklaruan që sjelljet e zyrtarëve policor pas arrestimit kanë qenë korrekte.

QKRMT shpreh shqetësim e përdorimit të forcës ndaj protestuesve në pikën kufitare në Merdare dhe Dheu i Bardhë, sidomos përdorimin i mjeteve si gaz lotsjellës, topa uji, sprej, si dhe shkopinj gome, duke lënë të lënduar dhjetra protestues.

**I - Rrjedha e Protestës së Lëvizjes Vetëvendosje në Merdare (Podujevë), 14 janar 2012**

Rreth orës 13:30 disa qindra protestues të Lëvizjes Vetëvendosje ishin mbledhur në rrugën Podujevë-Merdare rreth 4-5 km afër vendkalimit kufitar, pasi PK kishte vendosur postbllloqe të shumta para vendkalimit dhe nuk i kishte lënë të afroreshin protestuesit më pranë pikë-kalimit kufitar

Njësi të shumta policore dhe njësi speciale ishin vendosur para turmës së protestuesve të VV. Lideri i VV Albin Kurti me megafon derisa po thërriste vazhdimisht për protestë paqësore dhe njoftonte për qëllimin e protestës-se ajo drejtohet kundër Serbisë dhe qarkullimit të mallrave serbe në Kosovë dhe nuk ka të bëjë me popullin serb etj, dhe po iu bënte thirrje policisë që edhe ata të jenë paqësor dhe të mos provokojnë, nga një pjesëtar i Njësisë Speciale të PK-së i ka bërë thirrje me megafon protestuesve të lirojnë rrugën brenda 5 minutave. Protestuesit nuk kanë reaguar pas thirrjes, ndërsa rreth 15 min më vonë Njësia Speciale e PK-së është afruar dhe ka krijuar një kordon përpara protestuesve dhe menjëherë ka filluar ti shtyj ata me forcë me mbrojtëset e tyre prej plastike dhe t'i godasë. Pas kësaj protestuesit kane filluar te mbrohen duke mos pranuar të zbrapsen. Derisa PK-ja po i shtynte protestuesit prapa, disa gur kanë filluar të vijnë në drejtim të PK-së prej krahut të majtë të protestuesve. Dikush nga turma ka bërë thirrje për uljen e protestuesve për toke dhe kjo ka ndodhur nga ana e disa prej tyre, por nuk e ka bërë Policinë te zbusë sjelljen e tyre, përkundrazi ajo e ka ashpërsuar akoma me shumë sjelljen dhe ka filluar edhe të godasë në protestuesit dhe menjëherë ka filluar gjuajtja e gazit lotsjellës nga pjesëtarët tjerë të PK-së që po qëndronin prapa Njësisë Speciale. Po ashtu janë hedhur edhe bombola uji drejt protestuesve.

Protestuesit e VV ndërkohë i kanë shpeshtuar gjuajtjet me gurë drejt PK-së dhe disa shkopinjt druri të pankartave që i kishin me vete.

Në këtë kohë gjithçka ishte mbuluar nga tymi i gazit lotsjellës dhe PK ka shfrytëzuar rastin dhe ka kapur/arrestuar disa prej tyre. Grupe prej 3,4 e më shumë policëve vazhdimisht nxirrnin protestues nga turma dhe i dërgonin në automjetet e tyre. Protestuesit ende nuk po shpërndaheshin dhe vazhdonin me thirrjet Vetëvendosje, Vetëvendosje dhe Serbia Nuk Kalon!

Pas rreth 10 minutash nga fillimi i incidentit Njësitë Speciale të PK janë shoqëruar edhe nga kamioni i PK që gjuante ujë për ti shpërndarë protestuesit.

Janë vërejtur PK derisa po tërhiqnin zvarre një protestues (dy polic duke e kapur për dore) derisa protestuesi nuk bënte ndonjë rezistence. Po ashtu një tjetër ishte shtrirë në tokë dhe rezistonte të dorëzohej por nuk sillej në mënyre te dhunshme vetëm i ruante duart dhe kokën, ndërsa i qëndronin përreth 4 polic, njëri prej policëve është parë duke e goditur me këmbë derisa protestuesi ishte i shtrirë për toke. Pas kësaj policia kanë arritur ta kapin dhe ta dërgojnë në automjetin e tyre.

Turma e protestuesve ishte ndarë në 3-4 pjesë më të vogla dhe me secilën prej tyre merrej nga një pjesë e policisë, kryesisht forca të njësisë speciale. Janë vërejtur disa përpjekje të protestuesve për tu riorganizuar por kjo ishte e pamundur pasi ishte një numër shume i madh i policisë dhe tani protestuesit ishin të ndarë nëpër disa rrugë anësore në pamundësi për tu bashkuar.

Është interesant të thuhet se deri vonë nuk është para ndonjë auto-ambulancë edhe pse shihej se kishte disa protestues që kërkonin ndihmë si pasojë e mundimeve nga gazi lotsjellës po edhe lëndimeve si pasojë e rrëmujës dhe sjelljeve të policisë. Ndër ta kishte edhe pjesëtare të policisë që kërkonin ndihmë.

Ka kaluar afër gjysme ore dhe një auto-ambulance është shfaqur aty dhe ka filluar t'iu ofroj ndihmë të lënduarve.

Janë parë pjesëtarë të PK-së duke i ndjekur protestuesit edhe jashtë rrugës së asfaltuar Prishtinë – Podujevë (dmth arave) duke i ndjekur protestuesit për ti penguar ata që të shfrytëzojnë rrugët anësore për tu riorganizuar.

Protestuesit tani ishin në numër më të vogël dhe të shkapërderdhur, kurse policia po vazhdonte ti mbrapse ata me ndihmën e gazit lotsjellës dhe ujit që hidhej vazhdimisht nga automjeti i policisë. Arrestimet vazhdonin edhe pse nuk kishte ndonjë rezistence nga ana e protestuesve, madje tani nuk kishte as ndonjë thirrje apo reagim çfarëdo nga ana e tyre (dmth kishte dhjetëra të arrestuar)

Rreth orës 15:30 rruga ka filluar të zhblokohet dhe automjetet kanë filluar të qarkullojnë në drejtim të Prishtinës.

Nuk është vërejtur apo pohuar nga askush se gjatë kësaj kohe ka kaluar ndonjë automjet me mallra të Serbisë përveç një kamioni me targa të Novi Pazarit i cili duket se është drejtuar për në qytetin e Podujevës.

## **II - Rrjedha e Protestës së Lëvizjes Vetëvendosje te Dheu i Bardhë (Gjilan), 14 janar 2012**

Që nga ora 11 kishin filluar të mblidheshin protestuesit afër pikës kufitare tek Dheu i Bardhë, ku kryesisht vinin në mënyrë të organizuar si nga regjioni i Gjilanit po ashtu edhe nga komuna më të largëta si: Ferizajt, Suharekës, Prizrenit, Malishevës etj,. Sipas zyrtarëve policorë si dhe atyre të Lëvizjes Vetëvendosje numri i protestuesve ka qenë mbi 1000.

Në rrugën që shpie nga Gjilani deri tek Dheu i Bardhë (afërsisht 25 KM) vëreheshin forca të shtuara policore, ku në çdo lidhje të rrugës kishte nga një grup policësh.

Ashtu siç ishte paralajmëruar në orën 13:00 të gjithë protestuesit ishin 1 KM afër pikës kufitare Dheu i Bardhë, përkatësisht në trekëndëshin që lidh këtë pikë kufitare. Aty gjendeshin një numër i konsiderueshëm i zyrtarëve policor, ndërsa pikërisht në trekëndëshin e rrugës që shpie në pikën kufitare ishte kordoni i policisë nga njësisia speciale të cilët kishin bllokuar rrugën në drejtim të pikës kufitare.

Protestuesit në fillim qëndruan afër për-rreth parkingut të një pompe të benzinës dhe në njërën pjesë të rrugës magjistrale, por të njëjtit ishin të qetë dhe nuk pengon qarkullimin e automjeteve.

Trekëndëshi rrugor ku zhvillohej protesta është i rrethuar me vendbanime serbe, dhe kështu rreth orës 14 kanë filluar të dëgjohen disa brohoritje nga vendbanimet serbe (Ranillug dhe Korminjan) dhe në ato momente ka filluar gatishmëri si e policisë për veprim po ashtu edhe e protestuesve të cilët filluan të

brohoritnin si: “UÇK; Vetëvendosje; Albin Kurti; ” etj. Por për disa minuta kjo situatë u qetësua duke vazhduar me protestë të qetë dhe paqësore. Sipas informacionit zyrtarë të marrë nga policia, pas reagimit të banorëve të fshatrave serbe, përfaqësuesit e policisë janë takuar me kryetarin e këtij lokaliteti serb për normalizimin e situatës, me ç’rast edhe janë ndërprerë këto reagime nga banorët serb.

Gjatë gjithë kësaj kohe protesta vazhdonte e qetë dhe pa ndonjë reagim konkret as nga protestuesit e as nga ana e policisë. Zyrtarët policor ishin në kontakt të vazhdueshëm me organizatorët e protestës duke i lutur për përfundimin e kësaj proteste, mirëpo nga ana e organizatorëve nuk kishte ndonjë afat kohor se deri kur do të protestohesh. Përndryshe nga ora 16 ka pasur rënie të madhe të temperaturave (nën minus/-), mirëpo protestuesit vazhdonin të qëndronin në këmbë dhe kishin ndezur disa zjarri për t’u ngrohur, megjithëse numri i tyre ishte më i vogël se sa në fillim, ku protestuesit e vendbanimeve të afërta përfshirë edhe Gjilanin kishin filluar të largoheshin individualisht.

Nga ora 17 kur tani veç ishte errësuar filloi një ri-mobilizimi i policisë si dhe kërkesat e vazhdueshme për përfundim të protestës, me arsyetimin se gjenden mes vendbanimeve serbe dhe nuk mund t’i ofrojnë siguri për qëndrimin e mëtejshëm në këtë lokacion. Përveç kërkesës së vazhdueshme për shpërndarje e cila verbalist iu drejtohej organizatorëve (pa megafon), ultimatum nuk kishte. Por protestuesit megjithëse të lodhur nga të ftohtit, të qetë e vazhdonin protestën. Ndërsa policia përgatitnin aksionin për shpërndarjen e protestës.

Në orën 17:40 përveç policisë patrulluese të cilët po qëndronin pranë protestuesve dhe kordonit të policisë së njësive speciale të cilët ishin në të njëjtin pozicion që nga fillimi i protestës, tani janë ofruar grupi tjetër i policisë së njësive speciale të cilët deri në atë moment gjendeshin afër terminalit doganor tek pika kufitare. Ky grup i njësive speciale në ora 17:45 ka bërë një marsh të shpejt për rreth protestuesve, ku protestuesit të qetë janë ulur të gjithë në tokë dhe nuk kanë ndërmarr asnjë veprim. Më pas janë aktivizuar të gjithë policët: njësia speciale, policët patrullues si dhe është dal në pah një numër i konsiderueshëm i policëve civil. Megjithëse të gjithë protestuesit ishin të ulur dhe paqësor ka filluar aksioni i furishëm për arrestimin e tyre. Arrestimi i tyre është bërë shumë shpejt duke i nxjerrë protestuesit zvarrë, nga 3-4 policë me një protestues. Përkundër që arrestoheshin, protestuesit nuk kanë përdorur asnjë mjetë për kundërshtim të policisë dhe nuk kanë lëvizur nga vendi. Protestuesit gjatë arrestimit janë bartur zvarrë për toke e cila ishte e mbuluar me borë dhe akull. Arrestimit nuk i shpëtuan as disa të sëmurë mendorë si dhe invalid. Po ashtu në këtë mënyrë u arrestuan edhe deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës si dhe anëtar të Kryesisë së Kuvendit. Njëri nga deputetët (V.Y) gjatë arrestimit të tij është bartur zvarrë për shallin e tij që e kishte të vendosur në qafë, të cilën më pas e ka larguar nga qafa duke i shpëtuar ngufatjes. Po ashtu anëtari i Kryesisë së Kuvendit (G.K) u arrestua dhunshëm duke pësuar lëndime në pjesët frontale të fytyrës si dhe u shqelmua në bark me rast iu kishte vështirësuar frymëmarrja, ku edhe gjatë intervistës me të nga ekipi i QKRMT-së në lokalet e policisë, ai vërehej i zbehur.

Arrestimet vazhduan deri rreth orës 20 kur u shpërndanë të gjithë protestuesit.

Gjatë gjithës kohës së protestës, njëra krosi e rrugës ishte e lirë për qarkullim dhe në asnjë rast nuk është penguar qarkullimi i tyre. Ndërsa gjatë kësaj proteste nuk ka kaluar asnjë automjet me mallra nga Serbia, por duhet përmendur se ka pasur qarkullim të veturave të udhëtarëve me tabela të Serbisë të cilat kanë kaluar pa u penguar nga protestuesit.

Gjithë protesta dhe momentet e arrestimit janë përcjell edhe nga një numër i konsiderueshëm i mediave, dhe gjithashtu përveç ekipit të QKRMT-së është monitoruar edhe nga përfaqësues të Inspektoratit Policor të Kosovës.

Ekipi monitorues i QKRMT-së në ora 20 vizitoi Stacionin Policor në Gjilan, ku ishin transportuar të arrestuarit e protestës. Gjatë takimit me udhëheqësit e këtij stacioni, ata ishin mirënjohës për sjelljet korrekte të protestuesve. Numri i të arrestuarve në këtë aksion e që u dërguan në Stacionin Policor në Gjilan, ishte 36.

Ekipi i QKRMT-së gjithashtu takoi deputetët e arrestuar si dhe disa nga protestuesit e arrestuar, ku gjatë vizitës sonë në stacionin policor ishte prezentë edhe Kryeprokurorja e Prokurorisë Komunale në Gjilan, dhe lirimi i disa nga të arrestuarit filloi gjatë qëndrimit tonë në Stacionin Policor.

Në bazë të intervistave konfidenciale të realizuara me të arrestuarit në Stacionin Policor (pa praninë e zyrtarëve policor), ata janë shprehur që sjelljet e zyrtarëve policor pas arrestimit kanë qenë korrekte.

*Në vazhdim janë disa nga fotot e bëra gjatë protestës dhe momenteve të arrestimit:*











*Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) është organizatë e pavarur, jo qeveritare, jo fitimprurëse, themeluar në vitin 1999 me mision të ofrojë trajtim dhe rehabilitim për viktimat e torturës dhe të traumës.*

*Në kaudër të fushatës së saj për respektimin e të drejtave të njeriut dhe parandalimit të torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit apo denigrimit njerëzor, QKRMT që nga viti 2007, është duke zbatuar aktivitetet monitoruese në Qendrat Korrektuese, Qendrat e Paraburgimit dhe në Qendrat e Mbajtjes në Stacionet Policore.*